



Adresa: Rruga: "Shyqyri Ishmi", pallati 38, shkalla 1, apt 2, Tirane
e-mail: info@medpak.org / www.medpak.org

MEDPAK po kërkon trajnerë për projektin "Më lejo dhe mundëso përfshirjen time"

Në kuadrin e programit "Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor /ReLOaD" i cili financohet nga Bashkimi Europian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim shoqata MEDPAK është një ndër organizaatat fituese e cila po zbaton projektin "Më lejo dhe mundëso përfshirjen time". Ky projekt do të zbatohet në katër njësi administrative të bashkisë Elbasan, si një ndër 12 bashkitë partnere të Programit

Projekti do të përfshijë punën direkte me prindërit dhe të afërm të personave me Aftësi të Kufizuara. Ai do të synojë rritjen dhe fuqizimin e kapaciteteve të rrjetit të prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara, duke e bërë atë një faktor veprues për përmirësimin e përfshirjes sociale të PAK deri në vendimarrje të institucioneve lokale.

Në kuadër të zbatimit të këtij projekti kërkojmë trajnerë (1 ose më shumë trajnerë) për të organizuar trajnimin e nje grupi prindërisht dhe profesionistë (24 persona 6 nga cdo njesi administrative)me qëllim që të rrisim kapacitetet e tyre në njohjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe ti aftësojmë ata për advokim dhe lobim për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, për tu bërë pjesë në vendimarrjet lokale.

Fuqizimi i këtyre grupeve nga 6 persona nga cdo njësi administrative (prindër dhe profesionistë) do të bëhet me qëllimin që të jenë faktor në vendimarrjen lokale për të realizuar përfshirjen sociale të fëmijëve të tyre me Aftësi të Kufizuara në jetën e komunitetit.

Kualifikimet dhe niveli i përgatitjes për trajnerin që kërkohet:

- Diplomë në shkenca juridike, shkenca sociale, mësuesi.
- Të ketë përvojë si trajnerë për të drejtat, përvojë pune në shoqërinë civile dhe të jetë i/e njohur me mënyra të advokimit dhe lobimit, për të të drejtat e personave me aftësi të kufizuara; praktikat gjithpërfshirëse arsimore; sistemi arsimor i detyruar; fëmijët me aftësi të kufizuara dhe zhvillimi komuniteteve;
- Të ketë rrjedhshmëri në të shkruar dhe të folur të gjuhës shqipe.
- Aftësi në përdorimin e programeve kompjuterike, të tilla si Word, Power Point dhe internet.
- *Përparësi do tu jepet personave që jetojnë/punojnë në territorin e bashkisë Elbasan ose Librazhd.*



Adresa: Rruga: "Shyqyri Ishmi", pallati 38, shkalla 1, apt 2, Tirane
e-mail: info@medpak.org / www.medpak.org

Rolet dhe Përgjegjësitë:

Trajneri do të përgatisë modulën e trajnimit për këto tema:

a- Njohja e të drejtave të PAK, bazuar në legjislacionin kombëtar dhe Konventës Ndërkombëtare për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara (ligji për arsim, ligji për shërbime dhe vlerësim).

b- Informimi mbi Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm me fokus përfshirjen sociale të PAK dhe prindërve të tyre në vendimarrjen lokale.

c- Advokimi dhe lobimi, si organizohet një fushatë advokimi për përmirësimin e jetesës së tyre në komunitet, ose realizimin e një të drejte të shkelur për personat me aftësi të kufizuara, në njësitë e tyre administrative.

d- Çfarë është një shoqatë, si organizohen grupet e prindërve dhe PAK për mbrojtjen e të drejtave dhe përfshirjes sociale në jetën e komunitetit dhe si mund të bëhen faktor në vendimarrje.

Të përgatisë raporte për përvetësimin e trajnimit nga grupi që do të trajnojë duke vlerësuar njohuritë e grupit para dhe pas trajnimit, për çdo temë të trajnimit.

Të sigurojë përdorimin e mjeteve të duhura për vizibilitetin e materialeve të trajnimit dhe komunikimin e projektit për palët e interesuara.

Personi që mendoni të aplikojë për këtë pozicion pune të dërgojë :

- CV shoqëruar me fotokopje diplome dhe një reference nga një punëdhënës i mëparshëm.
- Një draft modul (abstract) se çfarë mendon të paraqesë në secilën temë
- Si dhe një letër interesi duke shprehur qartë se përse mendon se mund të jetë i përshtatshëm për të kryer këto trajnime.

Këto do të dërgohen në adresën: info@medpak.org para orës 17:00 deri të henen, datë **24 Dhjetor 2018**.